



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT



AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE TIRANË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE

INDUSTRIALE “PAVARËSIA ” VLORE

Nr. 637 Prot

Vlorë , më 18.11.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr 759 datë ,30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ”(të ndryshuar),

Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE “PAVARESIA “VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për 1 pozicione pune :

- Pozicioni 1 .

Dega-Elektroteknike për instruktor të praktikës profesionale (me kohë të pjesshme)

1. Kriteret të përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen e vendit të lirë si vijon:

- a)të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b)të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c)të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d)të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e)të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjelljes dhe komunikimit
- f)të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për instruktor të praktikës profesionale (me kohë të pjesshme) në ofruesit e AFP-së për vendin e lirë si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ,pas të mesme ose parauniversitare ,në të njëjtën fushë me kualifikimin / kulifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon .
- b) të ketë të paktën 3(tre)vjet përvojë pune në fushën ,më të cilat ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- d) aftësi të tjera nëse kërkohen

2.Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për vendin e lirë , duhet të përfshijë: -

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën + listen e notave
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi,të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- . Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ;
- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit public të AFP-së, brenda datës ,

03/12/2025.

3.Vlerësimi I kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 datë ,30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ”(të ndryshuar),

**DREJTOR
ING.GENTIAN BOCI**